

STRATEGJI E NOSA-s

INTEGRIMI EUROPIAN

2006-2008

1. Analiza e gjendjes dhe nevojave te fushes

Shqipëria i ka hyrë rrugës së integrimit europian që prej 14 vjetësh duke e shpallur këtë proces si drejtimin themelor të zhvillimit të saj politiko-shoqëror. Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është objektivi strategjik në programet e aktorëve kryesorë politikë e shoqërorë në vendin tonë. Arritja e këtij objektivi madhor do të thotë zhvillim dhe përparim ekonomik i vendit, zhvillim i demokracisë dhe ndërtim i një shteti efektiv sipas modelit europian.

Me hapjen e bisedimeve për Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Europian kanë hyrë në një fazë të re, cilësisht të ndryshme. Kjo qasje e re e ofruar nga BE ka në themel procesin e Stabilizim Asocimit, një përbërës i të cilit është Marrëveshja që po negociohet midis Qeverisë dhe Komisionit Europian. Marrëdhëniet e vendit tonë me Bashkimin Europian kanë reflektuar një paqëndrueshmëri të ndjeshme që prej fillimit të tyre. Teknologjia e ndryshimit në procesin e Integrimit Europian për vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, mund të përkufizohet shkurt me përparime të shpejta dhe me kthime mbrapa. Kthimet mbrapa, me paqëndrueshmërinë politike dhe krizat kanë provuar se përparimi në objektivin e integrimit varet nga thellësia e reformave të brendshme.

Integrimi Europian i Shqipërisë dhe i vendeve të tjera të rajonit që aspirojnë për anëtarësim nuk mund të ndodhë pa një revolucion paqësor që do të ndryshonte funksionimin e shtetit dhe të shoqërisë. Kësisoj Integrimi nuk është pronë dhe detyrë vetëm e Qeverive.

Integrimi europian si *një projekt i zhvillimit politik dhe të demokracisë* kërkon domosdoshmërisht pjesëmarrjen edhe të aktorëve të tjerë krahas atyre administratave. Si *projekt i zhvillimit ekonomik*, integrimi europian duhet të paraprihet me studime dhe strategji zhvillimi.

Integrimi Europian i vendit ndodh në dy rrafshë:

- Negociatat për Marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit: një rrafsh teknik që ka të bëjë me marrëveshjen për një kuadër ligjor të pajtueshëm me sistemin e BE.
- Reformimi i sistemit politik dhe ekonomik në Shqipëri: Një rrafsh praktik, që ka të bëjë me funksionimin praktik të sistemit politik dhe ekonomik europian. Aftësia për të sjellë ndryshime në këtë rrafsh është sfida e vërtetë e integrimit. Suksesi në këtë rrafsh do të prekë dhe do të ndryshojë jetën e përditshme të qytetarëve. Përparimi në integrimin europian duhet të matet me ndryshimet në këtë rrafsh.

Ecuria e deritanishme e procesit të Integrimit Europian, pare në të dy rrafshet, tregon qartë se është shënuar një shkallë përparimi në rrafshin teknik. Konkretisht, është negociuar pothuajse e gjithë Marrëveshja e Stabilizim Asocimit dhe palët - Qeveria Shqiptare nga njëra anë dhe Brukseli nga ana tjetër- kanë rënë dakord pothuajse për të gjithë kapitujt e saj.

Ndërsa përse i takon rrafshit të dytë, pra të reformave që përbëjnë në fakt thelbin e integrimit, përparimet janë të pakta dhe të pamjaftueshme. Kjo shpjegon arsyet përse Bashkimi Europain ngurron të nënshkruajë marrëveshjen, pothuajse të negociuar.

Më tej, ecuria e procesit të integrimit europian reflekton qartë se procesi është keqkuptuar të paktën në dy drejtime themelore:

- Në thelbin e tij që është i lidhur me suksesin e reformave politike ekonomike dhe shoqërore. Kështu, integrimi europian është reduktuar pothuajse në rrafshin e parë teknik dhe në një masë të konsiderueshme identifikohet si një çështje e Ministrisë së Integrimit dhe Komisionit Europian, si një marrëveshje për të cilën duhet të bien dakord Qeveria dhe Bashkimi Europian.
- Së dyti, Integrimi Europian është keqkuptuar në pikëpamjen e aktorëve. Gabimisht qeveria, madje vetëm Ministria e Integrimit Europian, mendohet përgjegjëse e vetme për integrimin.

Duke patur parasysh këtë situatë, NOSA propozon një strategji afatmesme (trivjeçare) për të ndihmuar procesin e integrimit europian me qëllim që procesi të mos kushtëzohet më nga politika,

por politika dhe e gjithë shoqëria shqiptare të drejtohet prej tij, me qartësinë dhe pretendimin për ta çuar procesin përpara.

2. Qëllimi kryesor i strategjisë

Në kushtet e tranzicionit të zgjatur drejt ekonomisë së tregut, zbutjes së varfërisë dhe demokratizimit të shoqërisë dhe institucioneve, kjo strategji synon të rrisë ndërgjegjësimin e shoqërisë për proceset integruese, duke bërë të mundur pjesëmarrjen e kontributin aktiv të grupeve të interesit në monitorimin e reformave dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit e të integritimit.

3. Objektivat kryesore të strategjisë

Objektivat kryesorë të strategjisë së NOSA-s në fushën e integritimit Europian për realizimin e qëllimit të lartpërmendur janë si më poshtë:

- Qartësimi i objektivit themelor të procesit të integritimit europian për të gjithë shoqërinë shqiptare duke u përpjekur që ai të shndërrohet nga një retorikë politike në një realitet të prekshëm për të gjithë; Rritja e njohurive dhe informacionit për procesin e Integritimit Europian, si një proces reformash të brendshme që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, forcimin e shtetit ligjor dhe të demokracisë.
- Ndihmesa për krijimin e kapaciteteve të domosdoshme për funksionimin dhe sjelljen e politikës, administratës publike dhe shoqërisë shqiptare në përputhje me standardet europiane;
- Rritja e kapaciteteve negociuese të “palës shqiptare” përmes kontributit të ekspertëve brenda dhe jashtë vendit, shqiptarë dhe të huaj.
- Nxitja e përfshirjes dhe angazhimit të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, autoriteteve vendore, mediave qendrore dhe lokale në procesin e bisedimeve me BE-në, duke zgjeruar dijenitë e tyre për BE-në dhe marrëdhëniet dypalëshe. Rritja e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit në shoqëri për kostot e përfitimet e procesit të integritimit europian
- Nxitja e mendimit alternativ mbi proceset të cilave u nënshtrohet aktualisht vendi ynë në përçapjet për integrim europian, nëpërmjet studimit të temave që lidhen

me BE-në dhe vecanerisht përshpejtimi i reformave në fushat më të rëndësishme dhe të cilësuar si me problematikat nga Bashkimi European si: administrata publike, ekonomia informale, krimi i organizuar dhe korrupsioni përmes ndërmarrjes së studimeve (policy paper).

4. Përshkrim i veprimtarive

Objektivat e mësipërme synohen të realizohen përmes katër drejtimeve të mëposhtme:

- Ndërgjegjësim dhe Informim për Procesin e Integritit European
- Oponence dhe mbështetje për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare nepermjet Studimeve (*policy paper*) dhe *Advocacy-Lobbying*
- Trajnim e formim kapacitetesh
- Botime

A. Fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi për procesin e integritit

Integrimi european është një nga armët kyçe në retorikën e sotme politike. Sidoqoftë, një sërë keqkuptimesh e perceptimesh të gabuara lidhen me këtë proces dhe janë të përhapura në të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, duke filluar që nga administrata publike, komuniteti i biznesit, media, madje edhe organizatat joqeveritare dhe, padyshim, publiku i gjerë. Një nga shkaqet e tërthorta të krijimit të këtyre miteve- që rrallëherë kanë të bëjnë me realitetin- është edhe mënyra e servirjes së këtij objekti nga ana e politikës, por shpeshherë edhe e *opinionberesve* shqiptarë. Integrimi European caktohet si synimi strategjik i Shqipërisë, pas të cilit- në imagjinatën kolektive – do të vijojnë zhvillimi ekonomik e shoqëror, ulja e kriminalitetit dhe prosperiteti i përgjithshëm. Në fakt, çka me ndërgjegje a padashur mbetet në hije, është se integrimi european është vetëm një mundësi të cilën një vend mund të zgjedhë ta shfrytëzojë në rast se ai ka dëshmuar kapacitetet e përshtatshme për zhvillim. Pra, integrimi european nuk duhet kuptuar si një proces në vetvete, por si zhvillimi ekonomik e shoqëror, forcimi i demokracisë e shtetit ligjor.

➤ *Objektivi/Grupet kryesore që do të synohen në këtë program të Strategjisë*

Objektivi kryesor i fushatës së ndërgjegjësimi do të jetë informimi i grupeve të shoqërisë dhe çmitizimi i procesit të integritit european duke ruajtur vecoritë e grupeve që iu drejtohet, duke shperndare:

1. **informacion bazë** në lidhje me historinë, institucionet, politikat themelore, marrëdhëniet Shqipëri-BE, i cili do ta bënte qytetarin shqiptar një *qytetar evropian 'pasiv'*; dhe
2. **informacion i detajuar dhe specifik**, në përputhje me pozitën profesionale dhe sociale të secilit qytetar i cili do të përpiqet ta bëjë qytetarin shqiptar një *qytetar evropian 'aktiv'* – duke luajtur një rol në tregun evropian të punës dhe të ideve si dhe duke përfituar nga mundësitë që realitetet evropiane ofrojnë për situatën e tij/saj specifike

Fushata e ndërgjegjësimit për integrimin evropian do të synojë *target* grupe të ndryshme:

- Administrata publike
- Shoqëria civile
- Mediat qendrore dhe vendore
- Komuniteti i biznesit,
- Pushteti vendor
- Universitetet dhe shkollat e mesme.

➤ *Veprimtaritë kryesore*

Fushata e Ndërgjegjësimit do të realizohet përmes veprimtarive të mëposhtme:

- a. Realizimi i **anketimeve** për të kuptuar perceptimet që kanë rreth integrimit evropian grupet kryesore të shoqërisë, si administrata publike, opinionberesit, etj. Grupet do të zgjidhen duke pasur parasysh aktorët që kanë përgjegjësi për reformat e integrimit evropian si dhe organizimet që kanë influencë në Shoqëri. Për shembull, është e rëndësishme se ç'mendon administrata publike, pushteti vendor, komuniteti i biznesit, komuniteti akademik dhe media për integrimin. Studimet e mëparshme tregojnë se ekzistojnë keqkuptime për procesin e integrimit.
- b. Organizimi i **seminareve** për integrimin në pikëpamje të reformave në qytete kryesore të vendit, duke synuar zhvendosjen e debateve që zakonisht zhvillohen në kryeqytet.
- c. **Leksione të hapura** në (psh) qytetet universitare, me pjesëmarrjen e lektorëve të mirënjohur vendas e të huaj.
- d. **Fushata në media**, organizimi i debateve të hapura mediatike.
- e. **Seminare me gazetarët** e mediave qendrore dhe lokale për të rritur kapacitetet dhe njohjen për integrimin evropian.
- f. Përgatitja dhe shpërndarja e **raporteve** që ndjekin dinamikën e integrimit.

Rezultatet

Pritet që fushata e ndërgjegjësimit dhe informimit të rritë nivelin dhe cilësinë e informacionit për çështjet e zhvillimit dhe reformave në vend në pikëpamjen e sfidës së integritit. Po ashtu, kjo fushatë synon të nxitë më tej angazhimin e grupeve të interesit në procesin e reformave e të përparimit, duke rritur ndjenjën e përkatësisë (ownership), si dhe duke pasqyruar qartë kostot, përfitimet dhe potencialet që rrjedhin nga integriti.

Treguesit e monitorimit

Mirëpritja e veprimtarive, shkalla e pjesëmarrjes, vëmendja e mediave e organeve politikëbërëse e opinioniste, ndryshimi i rezultateve të anketimeve për perceptimet në grupet e aktorëve, si edhe zhvillimi cilësor i angazhimit të tyre do të jenë vetëm disa nga treguesit e ecurisë së këtij programi të strategjisë. Më tej, programi i sondazheve në kuadrin e fushatës së ndërgjegjësimit do të shërbejë si një tregues efektiv i monitorimit të suksesit të kësaj fushate: karakteri periodik i sondazheve do të lejojë monitorimin e dinamikës së ndryshimit të njohurive e interesit të grupeve të synuara dhe do të vlerësojë ndikimin e veprimtarive ndërgjegjësuere.

B. Oponence dhe mbështetje për institucionet shqiptare dhe europiane në hartimin e dokumentave në lidhje me integritin europian - studimeve – rekomandime – advocacy-lobing

Faza aktuale në të cilën ndodhen marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Europian dikton nevojën që krahas fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere të kalohet paralelisht në një asistencë me të specializuar. Nevoja e një përfshirjeje më praktike dhe aktive të ekspertëve të shoqërisë civile, përtej konstatimeve akademike, por duke ofruar edhe alternativa zgjidhjesh, sugjeron ndërmarrjen e studimeve specifike për aspekte të ndjeshme të zhvillimit e arritjes së standardeve europiane - përgatitja e *policy paper* për çështjet më të rëndësishme të reformave. Studimet në formën e *Policy Paper* do të synojnë së pari t'u paraprijnë hapave të integritit¹ dhe së dyti të analizojnë dhe të paraqesin rekomandime për fushat kryesore që lidhen me integritin.

➤ *Objektivat*

Studimet jo vetëm do të bëjnë të mundur monitorimin e zbatimit të reformave në kuadër të strategjive në fusha të ndryshme të integritit, por do të ofrojnë edhe kontributin e shoqërisë civile për aktorët e ndryshëm politikë.

¹ Për shembull do të kishte qënë mjaft e dobishme nëse përpara nënshkrimit të marrëveshjes të Tregtisë së Lirë me vendet fqinje të ishin ndërmarrë studime për të patur të qarta përfitimet dhe efektet negative që rrjedhin për ekonominë, të paktën në fazën e parë të zbatimit të këtyre marrëveshjeve.

Objektivat kryesore që synohet të arrihen nëpërmjet këtij programi janë:

- Zgjerimi i rrethit të aktorëve (nga sektori civil) në procesin e konsultimit të zgjidhjeve të mundshme të sfidave që imponon integrimi;
- Forcimi i rolit të ekspertëve (të pavarur) të shoqërisë civile në procesin e integritit dhe “zyrtarizimi” i kontributit të tyre nëpërmjet përkrahjes (*advocacy*) dhe lobimit;
- Sensibilizimi i faktorëve kyç të shoqërisë shqiptare për sfidat e integritit duke ua paraqitur sa më qarte këtë proces;
- Forcimi i presionit dhe monitorimi i hapave të ndërmarra në realizimin e reformave nga ana e aktorëve politikë vendas të angazhuar në procesin e integritit.

Oponenca për politikeberesit do të përqendrohet në këto rrafshë:

i. Strategjitë qeveritare –NOSA do të mobilizojë ekspertizën e nevojshme për të bërë opionencën në lidhje me këto Strategji të përgjithshme ose Sektoriale (si p.sh. Plani Kombëtar për Adoptimin e Acquis).

ii. Strategjitë e përgatitura nga BE për Shqipërinë, por edhe për rajonin. NOSA do të jetë e gatshme të analizojë edhe strategji apo reforma të brendshme të BE-së, dhe sidomos ato që prekin rajonin tonë. Por fokusi do të jetë dokumentat dhe politikat e BE që i drejtohen vendit tonë.

iii. Vlerësimi i impaktit– mungesa themelore në lidhje me analizën e strategjive konsiston në analizën e impaktit të tyre në zhvillimin shoqëror të vendit. Me anë të hartimit dhe analizës së reformave dhe masave që duhen ndërmarrë për të vënë në vend strategjitë e miratuara dhe të vlerësimit paraprak të efekteve të tyre ndërhyrja e shoqërisë civile të specializuar do të mbush një mangësi akute të administratës tonë publike. Këto vlerësime do të bëhen qoftë në lidhje me aspekte politike, qoftë në lidhje me harmonizimin e legjislacionit.

Dy janë qasjet që do të përdoren për arritjen e këtyre objektivave:

- a. Përgatitja e *Policy Paper*
- b. *Advocacy - lobing*

a. Përgatitja e *policy paper*. Studimet në formën e *policy paper* do të jenë tematike dhe do të përqendrohen në fushat e identifikuara si më delikate dhe më problematike në pikëpamjen e integritit evropian, të tilla si:

- Ekonomia informale në Shqipëri
- Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, probleme dhe perspektiva
- Administrata Publike dhe Integrimi European
- Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni
- Zhvillimi i pabarabartë i rajoneve
- Levizja e lire dhe manaxhimi i kufijve

Zgjedhja e këtyre tematikave për të përgatitur studime në formën e Policy Paper është bazuar në faktin se çështjet e mësipërme konsiderohen nga Bashkimi European, por edhe nga aktorët e ekspertët lokalë, si pengesat kryesore në procesin e integritit European. Kështu për shembull ekonomia informale, krimi i organizuar dhe korrupsioni janë të lidhura drejtpërdrejt dhe janë rrjedhojë e shkallës së ulët të funksionimit të shtetit ligjor (Rule of Laë). Ndërsa te tjerat, janë të lidhura para së gjithash me zhvillimin ekonomik të vendit. Më konkretisht për çdo tematikë të zgjedhur:

Ekonomia Informale. Përmasat e ekonomisë informale në Shqipëri janë nga më ta lartat në rajonin e Ballkanit. Efektet negative të saj kanë të bëjnë me sigurinë njerëzore dhe me zhvillimin e vendit. Por para së gjithash kjo dukuri është e lidhur me parimin bazë të modelit european të funksionimit të shtetit dhe të ekonomisë: shtetin ligjor. Studimi në formën e *Policy paper* që propozojmë do të analizojë situatën aktuale, do të evidentojë ndikimet negative për zhvillimin e vendit, për funksionimin e institucioneve dhe do të ketë një numër rekomandimesh për reduktimin e këtij fenomeni.

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, probleme dhe perspektiva. Nën këtë tematikë do të bëhet një vlerësim i marrëveshjeve të tregtisë së lirë që vendi ynë ka nënshkruar me disa vende fqinje nën inkurajimin e Bashkimit European. Integrimi rajonal është një nga përbërësit më të rëndësishëm të integritit european. Kësisoj dështimi apo ngadalësimi i këtij përbërësi do të jetë një pengesë tjetër për afrimin e Shqipërisë me BE.

Administrata Publike dhe Integrimi European. Një nga problemet kritike të parashtruara në Raportin e Bashkimit European si dhe në dokumente të tjera është gjendja e administratës publike dhe kuotat relativisht të ulëta të profesionalizmit. Marrëdhëniet e Shqipërisë me BE do të vijnë duke u rritur çka kërkon edhe një përgatitje në rritje të administratës publike për t'iu përshtatur ndryshimeve. Aktualisht ka një pasuri në rritje që duhet përdorur për të fuqizuar administratën publike, për shembull me kontingjentin në rritje të atyre që kanë studiuar jashtë vendit. Studimi që propozojmë krahas analizës do të përmbajë edhe rekomandime përkatëse.

Krimi Organizuar dhe Korrupsioni. Në këtë tematike synohen të trajtohen aspekte të veçanta të këtyre dukurive, duke filluar së pari me perceptimet. Studimi synon të vendosë një raport më të qartë me perceptimet dhe realitetin rreth fenomenit të korrupsionit në mënyrë të veçantë dhe deri diku edhe krimin të organizuar. Më tej, studimi synon të ofrojë rekomandime për të reduktuar nivelet e korrupsionit dhe të krimin të organizuar, që konsiderohen si pengesa serioze në perspektivën e integritetit.

Zhvillimi i Pabarabartë i Rajoneve. Integrimi Europian është në themel një projekt ekonomik dhe si tillë ai s'mund të përparojë pa strategji të qarta të zhvillimit të vendit. Nënshkrimi i Marrëveshjes së SA nuk mund të sjellë mrekullinë dhe vetëm zhvillimi ekonomik do të përmirësojë standardet për qytetarët. Gjatë katërmbëdhjetë vjetëve të fundit në Shqipëri ka ndodhur një zhvendosje e madhe demografike dhe përqendrim i madh në zonën Tiranë-Durrës. Mirëpo zhvendosja ka ndodhur edhe në rajone të cilat kanë potenciale zhvillimi. Studimi që propozojmë do të analizojë zhvillimin e pabarabartë të rajoneve duke ofruar rekomandimet përkatëse, për një vëmendje më të madhe me investime dhe strategji zhvillimi për rajonet më pak të favorizuara.

Levizja e lire, migrimi i punes dhe manaxhimi i kufijve. Rasti i Shqipërisë duket se është unik në pikëpamjen e emigrimit, ku vetëm në Greqi dhe Itali ka emigruar 50 përqind e fuqisë punëtore. Deri tani emigracioni ka shërbyer për të reduktuar varfërinë, por jo për zhvillimin e vendit. Aktualisht ka një trend të qartë të rikthimit të shqiptarëve. Studimet do të analizojë fenomenin e emigrimit për të ofruar rekomandime në pikëpamjen e menaxhimit të emigracionit. Pjesë e këtij studimi do të jetë edhe dukuria e largimit të trurit. Në aspektet e levizjes së lire do të trajtohen çështje të menaxhimit të kufijve në Europën e ditëve tona.

b. Advocacy-lobim. Pas përgatitjes së çdo studimi – *Policy Paper* synohet të organizohen grupet e presionit (*advocacy*, lobim) përmes mediave, grupeve parlamentare. Në këtë fazë do të kërkohet që rekomandimet sipas fushave të studiuara të merren në shqyrtim nga Institucionet vendimmarrëse, qofshin nderkombetare, qofshin nderkombetare. Do të përdoren debatet dhe publikimi i rekomandimeve në media, por edhe debate me grupet parlamentare në rastet kur janë sugjeruar ndryshime në ligje apo krijim institucionesh.

Rezultatet

Programi i studimeve dhe i përkrahjes (*advocacy*) synon të ofrojë zgjidhje e alternativa të reja për zhvillimin në fushat e ndryshme të shoqërisë, duke ndihmuar për hartimin e politikave realiste e efikase.

Treguesit e monitorimit

Mirëpritja e studimeve e rekomandimeve të pasqyruara në to, vëmendja nga mediat e aktorët e tjerë të shoqërisë, si dhe rezultatet e arritura në vazhden e advocacy, me këshillimin e alternativave për zhvillim e zbatim, si dhe ndryshimet e arritura do të jenë disa nga treguesit e monitorimit për këtë program.

C. Trajnime dhe forcim kapacitetesh

Një nga kritikrat e vazhdueshme të BE-së për qeverinë shqiptare dhe përparimin e arritur prej saj në procesin e Stabilizim Asocimit ka qenë dhe vazhdon të jetë e lidhur me mungesën e kapaciteteve zbatuese të administratës publike. Krahas administratës publike, edhe ndër grupe të tjera interesi, si në komunitetin e biznesit, botën e medias, etj., mungojnë kapacitetet e duhura për të kuptuar qartë dhe shfrytëzuar sa më mirë përfitimet që rrjedhin nga procesi i integritit, ashtu si edhe detyrimet e barrën që lidhen me të.

➤ *Objektivi*

Qëllimi kryesor i këtij programi është të zgjerojë njohuritë mbi procesin e integritit / BE-në dhe të forcojë kapacitetet e faktorëve kyç në vend, të cilët njëkohësisht janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të involvuar në integrimin e Shqipërisë në BE.

➤ *Veprimtaritë kryesore*

Në funksion të realizimit të këtij objekti, NOSA do të zhvillojë programe trajnimesh për:

- *Administratën publike.* Krahas trajnimeve me ekspertë vendas dhe të huaj NOSA do të synojë lehtësimin e shkëmbimit të eksperiencës me vendet që janë në të njëjtin nivel marrëdhënesh me Bashkimin Europian. Por shkëmbime përvojash do të realizohen edhe me ekspertë të vendeve që kanë hyrë rishtazi në BE. Trajnimet do të paraprihen nga një pjesë e studimeve. Tematika do të përcaktohet nga grupet e synuara. Për shembull, për ekspertë të Ministrisë së Integritit programet do të jenë më të specializuara.
- *Komuniteti i Medias dhe politikane.* Duke pasur parasysh ndikimin e madh të medias në shoqëri për procesin e integritit europian janë të nevojshme trajnime për gazetarët në fushat politike, ekonomike e shoqërore. Nga studimet e mëparshme është vënë re se media përgjithësisht nuk ka njohuri të mjaftueshme për procesin, madje përvoja e deritanishme ka reflektuar keqkuptime serioze, për thelbin, afatet e integritit, detyrimet që rrjedhin në këtë proces, përfshirë edhe një mungesë informacioni për BE, institucionet dhe zgjerimin. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të një berthame

gazetarësh të specializuar për çështjet europiane të cilët t'i nënshtrohen një trajnimi intensiv. Do të organizohen edhe trajnime me parlamentarët, gje që kërkon një punë më të qëndrueshme me Komisionet Parlamentare.

- *Pushteti vendor.* Nga përvoja dhe studimet e deritanishme rezulton se organet e pushtetit vendor nuk e konsiderojnë integrimin një çështje të tyre, por si "diçka që ndodh në Tiranë" ose me të cilën merret Qeveria qendrore. Trajnimet me përfaqësues të pushtetit lokal do të synojnë të rritin jo vetëm nivelin e informacionit për integrimin, por do të synojë edhe aftësimin e tyre në përgatitjen e projekteve të zhvillimit. Programi synon gjithashtu edhe shkëmbimin e eksperiencës së vendeve që kanë hyrë rishtazi, ose që janë më përpara se Shqipëria në procesin e integritit.
- *Nxenesit e shkollave.* Ketu, NOSA mban parasysh nevojën për një analizë të nivelit të mësimdhënies të parimeve të funksionimit të demokracisë europiane në shkolla, në përputhje me nivelin e mësimdhënies, dhe që synon të ofrojë modifikime të programeve mësimore përkatëse që të mund të ndikohet tek nxënësit me këto koncepte themelore.
- *Gjyqësor.* Shkollës së Magjistraturës i ofrohet nje program trajnimi te vazhduar për çështje të integritit europian me gjyqtarë dhe prokurorë qe nga viti 2001. Në kuadrin e NOSA-s do të ishte e domosdoshme që edhe për avokatët të bëheshin trajnime specifike për të drejtën komunitare.
- *Dhomat e Tregëtisë dhe sindikatat.* Aspektet e së drejtës europiane materiale dhe ekonomike nuk janë të njohura në Shqipëri. NOSA do të bëjë përpjekje për ndergjegjesimin dhe trajnimin e grupeve të interesit të biznesit për një nga drejtimit themelore të ndërhyrjes duke patur parasysh rolin e biznesit në kuadrin e integritit europian.

Rezultatet

Rritja e nivelit të aftësive për integrimin; kuptim më i mirë i proceseve integruese/reformave; përmirësimi i kapaciteteve zbatuese nëpërmjet benchmarking me vende të tjera të Europës Qendrore e Lindore; rritja e kapaciteteve negociuese të palës shqiptare, etj.

Treguesit e monitorimit

Treguesit e monitorimit për programin e trajnimeve përfshijnë pjesëmarrjen e interesin e grupeve të synuara për trajnimet, cilësinë e informacionit e njohurive të tejçuara, rezultatet e formularëve të vlerësimit të pjesëmarrësve, testimi i njohurive pas programeve trajnuese etj.

Më tej, tregues subjektivë për efektivitetin e trajnimeve do të jetë rritja e kapaciteteve për zbatim e grupeve të synuara, nëpërmjet rezultateve të arritura në fushat përkatëse.

D. Botime

Botimet, të cilat nga pikëpamja e objektivit kryesor dhe rezultateve që synohen të arrihen janë në vazhdimësi me drejtimet pararendëse të fushës, përbëjnë drejtimin e katert të Strategjisë Trevjeçare të NOSA-s për Integrimin Europian.

NOSA do të përdore në këto drejtim kapacitetet e anetareve të fushës të konsoliduara nëpërmjet implementimit të një sërë iniciativash. NOSA dhe anetarët e saj, nga programet e mëparshme që kanë zbatuar, kanë arritur të vendosin dialog me studentët e studiuesit shqiptarë që banojnë aktualisht jashtë vendit, të cilët përbëjnë një potencial mjaft premtues jo vetëm për të ofruar këndvështrime të përvoja të reja në programin e botimeve, por edhe si burime njerëzore të shumëpritura të cilët mund të ofrojnë përvoja, njohuri e përjasje të reja për zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe posaçërisht për integrimin evropian.

➤ *Objektivi*

Qëllimi kryesor i këtij programi të Strategjisë është sjellja e problematikave të procesit të integritit më afër rretheve të ndryshme të shoqërisë shqiptare, duke e bërë atë më të kuptueshëm për një auditor më të gjerë.

➤ *Veprimtaritë kryesore*

Do të synohen botime me fokus zhvillimet evropiane, sfidat e tranzicionit; problemet, perspektivat dhe potencialet e mundshme të shoqërisë shqiptare. Botimet nuk do të jenë akademike dhe do t'u drejtohen një komuniteti të gjerë njerëzish, nxënësve dhe studentëve, mësuesve të të gjitha niveleve të sistemit arsimor, përfshirë edhe pedagogët, organeve të pushtetit lokal, përfaqësuesve të sindikatave, organizimeve të tjera shoqërore, rrjeteve të OJF, partive politike, drejtuesve lokalë të tyre, etj.

Rezultatet e pritshme nga ky grup aktivitetesh

- Ekspertët shqiptarë të angazhuar direkt në procesin e stabilizimit asociativ, do të kenë mundësi të shkëmbejnë dhe diskutojnë idetë, mendimet dhe opinionet e tyre në nivele profesionale brenda vendit duke patur mundësi për reagime, thithje mendimesh dhe ekspertize, në mënyrë që të ngrenë në nivele më të larta ekspertizën e tyre.
- Ekspertët dhe publiku shqiptar në përgjithësi do të ketë mundësi të marrë pjesë në mënyrë konkrete dhe shkencore në përpunimin e mendimit shqiptar në lidhje me procesin e integritit evropian.

Programi i botimeve pritet që ta nxitë në mënyrë efikase debatin publik mbi problemet më delikate me të cilat haset shoqëria shqiptare, duke bërë të mundur përballjen e këndvështrimeve e alternativave, shkëmbimin e përvojave rajonale, motivimin e grupeve shoqërore për angazhim më aktiv për zgjidhjen e dukurive më shqetësuese të vendit.

5. Kapacitetet Zbatuese

Kapacitetet e organizatave kryesore partnere që do të marrin pjesë për zbatimin e kësaj strategjie janë të tilla që ofrojnë garanci për arritjen e objektivave.

AIS ka një staf me kohë të plotë prej 9 personash, pa përfshirë këtu edhe numrin e praktikantëve vullnetarë të inkuadruar në programin e përhershëm Internship. Për më tej, AIS ka edhe një staf me kohë të pjesshme prej 6 vetësh, si edhe bashkëpunon me një sërë profesionistësh e studiuesish të cilët kontraktohen ad hoc sipas kërkesave të projekteve. Kapacitetet teknike në përdorim të AIS përbëhen nga 9 kompjuterë në 5 zyra, lidhje e përhershme me internetin, rrjet i brendshëm kompjuterik, rrjet i brendshëm telefonik, një makinë fotokopjuese, një printer, etj. AIS ka gjithashtu një bibliotekë me një fond mjaft të pasur me tituj shqiptarë e të huaj, ndër të cilët rreth 6 botime të AIS mbi çështje të integritimit në strukturat euroatlantike.

AIS ka një përvojë shumë të mirë bashkëpunimi me partnerë vendorë e të huaj, që nga organe të administratës publike qendrore e vendore, tek OJQ e qendra të tjera studimore qendrore e vendore, deri te mediat e shkruara e elektronike. Marrëdhëniet e lidhura gjatë punës shumëvjeçare të Institutit sigurojnë potenciale shumë optimiste për bashkëpunim të frytshëm edhe më tej, në vazhdim të strategjisë trivjeçare për integrimin evropian.

Stafi i Qendrës Europiane përbëhet nga specialistë që janë edukuar në të njëjtën shkollë me stafin e Komisionit Evropian, *Kolegjin e Evropës*, kanë kryer stazhe në Komision dhe që kanë marrëdhënie preferenciale me struktura evropiane në Shqipëri dhe jashtë saj. Pjesa më e madhe e ekspertëve të Qendrës vazhdimisht kanë përbërë referencën profesionale në lidhje me çështjet evropiane për institucione shqiptare ose evropiane.

6. Angazhimi i partnereve jashtë NOSA-s

Partnerët me të cilët kanë bashkëpunuar si AIS ashtu edhe Qendra Europiane perfaqesojnë organizatat lidere në sektorin e tyre përkatës, një pjesë të të cilëve kanë punuar në keto drejtime

ne menyre te vazhduar: Me poshte renditen disa nga partneret lokale qe do te jene partnere te jashtem ne zbatimin e kesaj strategjie:

- *Instituti i Medias*: për programin e trajnimeve e ngritjes së kapaciteteve, veçanërisht në lidhje me mediat.
- *Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale* për përgatitjen e *policy paper* që lidhen me emigrimin, si dhe zhvillimin e pabarabartë ta rajoneve
- *Zyra për Mbrojtjen e Qytetarit*: për çështjet që lidhen me korrupsionin
- *Televizione*: TVSH, ARBËRIA, ALSAT, TOP CHANNEL, KLAN si dhe televizionet lokale për fushatën mediatike.
- *OJQ lokale* në Shkodër, Vlorë, Pogradec, Sarandë, Fier, Korçë etj.

Institucione publike:

- Administrata publike qendrore, në veçanti Ministria e Integritit, Ministria e Punëve të Jashtme
- Pushteti vendor
- Përfaqësues të forcave politike
- Komisionet parlamentare

Kjo strategji trevjeçare do të realizohet gjithashtu duke bashkëpunuar me qendra dhe institute të ngjashme në rajon dhe Europë:

- Qendra e Studimeve Europiane Bruksel
- Qendra për Refromat Europiane Londër
- Programi European i ELIAMEP Greqi
- Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare Romë
- Qendra për Europën Juglindore Berlin
- Institutet dhe qendrat në Kroaci, Hungari, Bullgari, Rumani, Serbi dhe Mali i Zi, Maqedoni.
- Delegacioni European ne Tirane
- Keshilli i Europes, etj

7. Mobilizimi i resurseve nga palë të treta

Ekzistenca e Qendrës Evropiane në gjashtë vjetët e veprimtarisë së saj është varur, në mënyrë unike në Shqipëri, vetëm nga projekte të fokusuar drejtpërdrejt në çështjet e integritit evropian. Kjo eksperiencë ofron provën më të mirë që Qendra, më shumë akoma në kushtet e një mbështetjeje në kuadrin e NOSA, do të arrijë të mobilizojë burime të vazhdueshme në projekte të fokusuar në çështjet e integritit evropian.

Instituti i Studimeve Ndërkombëtare prej disa vitesh ka ndërmarrë dhe zbatuar një sërë iniciativash në fushën e integritit evropian. Në këtë mënyrë, AIIIS tashmë ka krijuar një rrjet të qëndrueshëm donatorësh të cilët kanë mbështetur projekte të ndryshme për çështjet e integritit Evropian. Disa prej tyre janë: Fondacioni Friedrich Ebert; Programi CERGE për Zhvillimin Ndërkombëtar; Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë; Ambasada Britanike. etj

Përveç mbështetjes së tyre, si AIIIS, ashtu edhe Qendra Evropiane, do të bëjnë hapa konkrete me qëllim përfshirjen edhe të donatorëve të tjerë në zbatim të kësaj strategjie. Kjo do të bëhet jo vetëm duke shfrytëzuar thirrjet e ndryshme për projekte por edhe duke vendosur kontakte të drejtpërdrejta me donatorë, fokusi i të cilëve përfshin edhe çështjet që trajton Strategjia e NOSA-s për Integritimin Evropian.

8. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të strategjisë

Ashtu si gjithë anëtarët e tjerë të NOSA, edhe AIIIS dhe Qendra Evropiane do t'i nënshtrohen mbikqyrjes dhe vlerësimit nga Bordi/bordet politikeberese dhe vendimmarrese të rrjetit. Te dy organizatat do të përbushin kërkesat për raportim dhe transparencë duke siguruar përputhjen e outputeve me objektivat. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të strategjisë do të bëhet edhe nga vete organizatat, përfaqësues të donatorit / donatorëve dhe të grupeve të synuara / të përfituesve me ndihmën e disa metodave si: pyetësorë (për rritjen e ndërgjegjësimit publik, roli i shoqërisë civile), formularë vlerësimi (për trajnimet) dhe metoda të tjera që, në varësi të programeve, do të vlerësojnë elementë si pjesëmarrja, interesi, njohuritë, intensiteti i debateve, ndryshimet tek grupet e synuara etj.

Në rastet kur qëllimi i projektit është konkret si për shembull analiza apo përmirësim standardesh, monitorimi do të bëhet nga vlerësues të jashtëm.

9 . Plani i qëndrueshmërisë

Objektivat kryesore të strategjisë janë hartuar në mënyrë të tillë që të mund të influencojnë grupet e synuara (kapacitetet, njohuritë, ekspertizën dhe shkallën e involvimit të tyre) dhe të mundësojnë rezultate të qëndrueshme në procesin e integritit evropian (duke nxitur debate, studime dhe promovim të mendimit “ndryshe” në lidhje me shumë elementë të proceseve integruese). Kemi të bëjmë me aspekte (procese dhe aktorë) të integritit evropian në Shqipëri të cilat, me zbatimin e kësaj strategjie dhe përmbushjen e objektivave të saj, do të shënojnë zhvillime dhe ndryshime thelbësore, të qëndrueshme dhe mjaft të rëndësishme për përshpejtimin e këtij procesi. Më tej, një nga shtyllat kryesore të veprimtarive të kësaj strategjie mbështetet në përçimin e njohurive dhe përshkallëzimin e dialogut e interesimit të shoqërisë. Kjo metodë synon përmirësimin e kapaciteteve duke ushqyer tek aktorët e ndryshëm të shoqërisë *ownership* të procesit, pra duke mundësuar ne analize te fundit qëndrueshmërinë afatgjatë te impaktit te kesaj strategjie.

10. Shkëmbimi i Informacionit

Mes anëtarëve të fushes dhe partnerëve në fushat e tjera te NOSA-s informacioni do të ofrohet qoftë me anë të raporteve periodike në lidhje me projektet e ndryshme, qofte me ftesat nëpër aktivitete me news ad hoc në lidhje me aktivitetet etj.

Gjatë zbatimit të kësaj strategjie, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit të bashkëpunimit me institucione të sektorit civil (partnerë brenda dhe jashtë NOSA-s), si edhe me organizata te tjera nga rajoni. Në realizimin e projekteve ne kuader te strategjise, do të bashkëpunohet ngushtë me OJQ lokale dhe të huaja (në varësi të fushës së ekspertizës dhe të interesave të strategjisë) cka do të mundësojë vendosjen e kontakteve permanente midis tyre nëpërmjet te cilave do te shkëmbehen informacione mbi ecurinë e implementimit te hapave te integritit. Te dyja organizatat zbatuese te kesaj strategjie do te ngarkojne nje anetar te stafit te tyre me detyrën e shkëmbimit të informacioneve me partnerët. Personi përgjegjës për kontaktet do të bëjë të mundur përditësimin dhe koordinimin e punës veçanërisht me anetaret e tjere te NOSA-s.

PLANI I VEPRIMEVE NDËRGJEGJËSUESE DHE INFORMUESE

Objektivi	Veprimtaria	Periudha e zbatimit	Organizata implementuese	Treguesit e monitorimit
<p><i>Informimi i opinionit publik për aspektet kryesore të integrimit</i></p> <p><i>Paraqitja e sfidave të integrimit: cilat janë problemet kryesore dhe çfarë reformash e ndryshimesh mbart ky proces</i></p>	<p>Fushatë në media</p> <p>Përgatitje raportesh/broshurash</p> <p>Leksione të hapura</p>	<p>Në vazhdimësi, veçanërisht vitin e parë</p>	<p>-AIIS –QE</p> <p>-Lëvizja MJAF!</p> <p>-Anetare të tjera të NOSA-s</p> <p>-Media</p>	<p>Audienca</p> <p>Niveli i programeve në media</p> <p>Pjesëmarrja në aktivitete</p> <p>Pasqyrimi në shtyp</p>
<p><i>Nxitja e dialogut dhe angazhimit më aktiv i grupeve të interesit, sensibilizimi për procese reformuese specifike</i></p>	<p>Seminare për integrimin/reformat</p> <p>Seminare me gazetarë</p> <p>Publikimi i rekomandimeve të studimeve në media</p>	<p>Në vazhdimësi, veçanërisht gjashtëmujorin e dytë dhe të tretë</p>	<p>- AIIS –QE në bashkëpunim me aktoret e fushës së shoqërisë civile</p>	<p>Pjesëmarrja</p> <p>Vlerësimi nga dhe i pjesëmarrësve</p> <p>Pasqyrimi në media</p>
<p><i>Shmangja e keqkuptimeve</i></p> <p><i>Përmirësimi i kuptimit të procesit të integrimit</i></p> <p><i>Monitorimi i procesit/fushatës</i></p>	<p>Sondazhe</p> <p>Fushata ndergjegjëse</p> <p>Debate publike</p>	<p>Periodikisht</p>	<p>- AIIS</p>	<p>Treguesit e sondazhit</p> <p>Përqindja e përmirësimit të njohurive</p> <p>Qëndrimi i opinionit publik ndaj integrimit</p>

PLANI I VEPRIMIT TE STUDIMEVE – OPONENCA – ADVOCACY- LOBIM

Objektivi	Veprimtaria	Periudha e zbatimit	Organizata zbatuese	Treguesit e monitorimit
<i>Zgjerimi i rrethit te aktorëve nga sektori civil në konsultimin e zgjidhjeve të sfidave të integritetit dhe konsolidimi i rolit të tyre</i>	Përgatitja e studimeve për çështje si: Ekonomia informale, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (probleme, perspektiva). Administrata Publike dhe Integrimi European, Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni, Zhvillimi i pabarabartë i rajoneve, Emigracioni dhe zhvillimi i vendit	Në vazhdimësi	-AIIS- QE -Instituti i Studimeve Bashkëkohore - Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale - Zyra për Mbrojtjen e Qytetarit	Mirëpritja e studimeve dhe rekomandimeve të pasqyruara në studime Vëmendja nga mediat e aktorët e tjerë të shoqërisë
<i>Forcimi i presionit dhe monitorim i realizimit të reformave nga ana e aktorëve politikë vendas të përfshirë në procesin e integritetit (Nxitja e dialogut dhe e interesit të shoqërisë për zhvillimet në vend, përparimin e reformave, minimizimin e dukurive negative si korrupsioni e ekonomia informale.)</i>	-Organizim i grupeve të presionit -Advocacy, lobim përmes mediave, - Advocacy/lobim përmes grupeve parlamentare.	Në vazhdimësi	- AIIS – QE -OSFA -Partners Albania -MJAFT - Televizione kombëtare dhe lokale:	Hartimi i politikave të reja nga ana e aktorëve politike
<i>Përshpejtimi i reformave në fushat më</i>	Advocacy, lobim, debate me	Në vazhdimësi	- AIIS- QE	Ndryshimet e arritura në fushat që

<i>të rëndësishme dhe të cilësuar si me problematikat nga Bashkimi Europian nëpërmjet “zyrtarizimit” të kontributit të ofruar nga studimet e ndërmarra</i>	grupet parlamentare dhe me përfaqësues të pushtetit ekzekutiv		<ul style="list-style-type: none"> - ISB-COPLAN-IPLS - Partnere te NOSA-s 	do të analizohen nga studimet; rezultatet e arritura në vazhden e advocacy me këshillimin e alternativave për zhvillim e zbatim
<i>Sensibilizimi i faktorëve kyç të shoqërisë shqiptare për sfidat e integritit</i>	Organizim i debateve të hapura dhe publikimi i rekomandimeve të studimeve në media	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - AIIS -QE - Lëvizja MJAFT! 	

PLANI I VEPRIMIT TE TRAJNIMEVE

Objektivi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Organizata zbatuese	Treguesit e monitorimit
<p>Forcimi i kapaciteteve dhe njohurive të përfaqësuesve të administratës publike, mediave dhe pushtetit vendor mbi procesin e integritit dhe BE-në, duke nxitur kështu përfshirjen dhe angazhimin e tyre në procesin e bisedimeve me BE-në;</p> <p>(Rritja e kapaciteteve negociuese të “palës shqiptare” përmes kontributit të ekspertëve brenda dhe jashtë vendit,shqiptarë dhe të huaj.)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Program trajnimesh mbi tematika të veçanta të integritit për grupet e synuara; - Takime (tryeza të rrumbullakëta) që synojnë shkëmbim eksperience me përfaqësues të huaj (nga shtetet me përvojë më të konsoliduar në integritimin europian). 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - AIIS –QE - Anetare te NOSA-s - Instituti i Medias 	<ul style="list-style-type: none"> - pjesëmarrja dhe interesi i treguar nga grupet e synuara për trajnim; - cilësia e informacionit dhe e njohurive të tejçuara (nëpërmjet formularëve të vlerësimit); - shkalla e rritjes së kapaciteteve për zbatim e grupeve të synuara, nëpërmjet rezultateve të arritura në fushat përkatëse (nëpërmjet pyetësorëve).

PLANI I VEPRIMIT TE BOTIMEVE

Objektivi	Aktiviteti	Periudha e implementimit	Organizata implementuese	Treguesit e monitorimit
<p>Njohja e rretheve të ndryshme të shoqërisë shqiptare me problematikat e procesit të integrimit dhe nxitja e mendimit akademik e studimor mbi proceset të cilave u nënshtrohet aktualisht vendi ynë.</p>	<p>- Botime të kontributeve të stafit të AIIS dhe QE si dhe të studiuesve / ekspertëve të huaj dhe shqiptarë me interes për synimet e Integrimit European;</p> <p>- Botim i përmuajshëm (jo akademik) me fokus në zhvillimet europiane, sfidat e tranzicionit; problemet, perspektivat dhe potencialet e mundshme të shoqërisë shqiptare</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>-AIIS – QE -Anetare te NOSA-s -Orgnaizata think – tank</p>	<p>- shkalla e intensifikimit të debatit publik mbi problemet më delikate me të cilat haset shoqëria shqiptare; - Shkalla e rritjes së njohurive tek grupet e synuara për çështjet e integrimit european;</p>